

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Pejës 2013

Prill 2013

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale tri vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Hyrje	4
2. Problemet në Komunën e Pejës.....	5
3. Performanca buxhetore e Komunës së Pejës.....	7
4. Investimet kapitale	11
5. Aktivitetet e Prokurimit Publik	13
6. Administrata e Komunës së Pejës	14
7. Arsimi në Komunën e Pejës.....	15
8. Transparenca në Komunën e Pejës.....	17
9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009.....	19
10. Burimet.....	22

Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Pejës udhëhiqet nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Peja është komuna me numrin më të madh të drejtorive komunale dhe numrin më të madh të nën kryetarëve komunal, në krahasim me të gjitha komunat tjera. Përpyekjet e udhëheqësve të Komunës për t'i adresuar nevojat dhe kërkesat e qytetarëve nuk kanë munguar, por edhe përkundër kësaj, pjesa dërrmuese e problemeve me të cilat janë përballur qytetarët para zgjedhjeve lokale të vitit 2009 vazhdojnë të ekzistojnë edhe më tutje.

Të dhënat zyrtare tregojnë për shifra të mëdha të shpenzimit të parasë publike në disa kategori të buxhetit. Kësisoj Peja më shumë shpenzon para gjatë një viti për mirëmbajtjen e veturave se sa për mirëmbajtjen e rrugëve. Gjatë vitit 2012 para për mirëmbajtjen e veturave janë shpenzuar mbi 97.714 euro, përderisa për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe auto rrugëve në total janë shpenzuar 80.796 euro. Për tri vite (2010-2012) për mirëmbajtjen e automjeteve janë shpenzuar mbi 220.000 euro. Komuna e Pejës në tri vitet e fundit ka shpenzuar për udhëtime jashtë vendit, mëditje dhe akomodim mbi 86.000 euro. Për të njëjtën periudhë (2010-2012) në telefona mobil dhe fiks ka shpenzuar mbi 196.000 euro. Ndërkaq, nëse i llogarisim shpenzimet për naftë për gjenerator dhe vetura, pa përfshirë naftën për ngrohje, del se Komuna e Pejës për tri vite ka shpenzuar mbi 675.000 euro. Vetëm në vitin e fundit (2012) për dreka e darka janë shpenzuar 76.820 euro, naftë për gjenerator 99.005 euro. Në tri vitet e fundit (2010-2012) vetëm naftë për gjenerator janë shpenzuar nga Komuna e Pejës mbi 212.000 euro.

Nënkryetari Shefqet Ukaj, pas aderimit në AAK të ish Kryetarit të Pejës nga radhët e LDK-së Ali Lajçi, pranon të dorëzoj postin e nënkryetarit dhe në vend të tij të emërohet nënkryetar Ali Lajçi. Ekzekutivi i Komunës së Pejës pranon tërheqjen e Ukaj në korrik të 2012 dhe vendos që djalin e tij Sokol Ukaj ta emëroj Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, duke shkarkuar nga kjo pozitë drejtoreshën e deriatëhershme Zana Radoniqi.

Problem për Komunën e Pejës konsiderohet mungesa e objektit për shkollën e mesme të mjekësisë. Mbi një mijë nxënës të kësaj shkolle i zhvillojnë mësimin në objektin e shkollës fillore "Ramiz Sadiku". Objekti për shkollën e mjekësisë është premtuar që do të nis së ndërtuari që pesë vite nga ana e autoriteteve të komunës, por kjo nuk ka ndodhur. Biznesmeni dhe deputeti nga Peja Ramiz Kelmendi ka nisur me fondet e tij të ndërtojë këtë shkollë, por me kusht që emri i babait të tij t'i vihet shkollës. Ky kusht është pranuar nga ana e përgjegjëseve të komunës, por jo edhe nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Kjo ka bërë që biznesmeni Kelmendi të heqë dorë nga investimi i mëtutjeshëm në ndërtimin e shkollës.

Në këtë raport, i cili përshkruan gjendjen e qeverisjes lokale tri vite pas zgjedhjeve të 2009, Instituti GAP raporton për mënyrën e shpenzimit të parasë publike, gjendjen në arsim, shëndetësi, transparencën komunale, problemet më të mëdha të komunës dhe realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në fushatën zgjedhore të 2009.

1. Hyrje

Komuna e Pejës udhëhiqet nga z.Ali Berisha (AAK). Viti 2013 shënon vitin e gjashtë në krye të detyrës si Kryetar Komune, kurse ky është mandati i tij i dytë qeverisës.

Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Peja ka rezultuar t'i ketë 96.450 banorë.¹ Kjo komunë rreshtohet e treta në vend pas Prishtinës dhe Prizrenit për nga numri i popullsisë, ndonëse udhëheqësit e Pejës më parë patën pretenduar se kjo komunë është menjëherë pas Prishtinës për nga numri i popullsisë.² Komuna e Pejës grantin nga niveli qendror vazhdon ta tërheq për 115.000 banorë.³ Ky dallim mes numrit të banorëve të paraparë në skenën e granteve dhe numrit të dalë nga regjistrimi i popullsisë pritet që në të ardhmen ta shkurtojë grantin qeveritar për Komunën e Pejës.⁴

Komuna e Pejës ka gjithsejtë 14 Drejtori. Për dallim nga Komunitat e tjera të vendit, në këtë komunë është e formuar edhe Drejtoria për Integritet dhe Diasporë si dhe Drejtoria për çështje Pronësore dhe Juridike. Nga 14 Drejtori, dy nga to udhëhiqen nga femrat, përkatësisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi Komunal i Pejës përbehet nga 41 asamblistë. Përfaqësimi i partive politike në Kuvend është relativisht i gjerë. Kësisoj 13 asamblistë janë të AAK, nëntë janë të LDK, gjashtë janë të PDK-së, katër të LDD, dy të AKR, dy të PSD, një i Partisë së Drejtësisë (PD), një IRDK, një VAKAT, një SDP dhe me një asamblistë përfaqësohet SDA. AAK në Pejë nuk ka arritur t'i fitojë shumicën e ulëseve në Kuvendin Komunal. Për rrjedhojë ky subjekt politik ka hyrë në koalicion me LDD. Nga marrëveshja e koalicionit, partnerët (AAK-LDD) janë pajtuar që LDD të ketë pozitën e nënkryetarit të komunës si dhe të udhëheq me Drejtorinë e Diasporës dhe me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik. Pas dy vite qeverisje, në janar të 2012 nënkryetari i Komunës nga radhët e LDD Shefqet Ukaj, së bashku me dy drejtorët e Drejtorive me të cilat ka udhëhequr LDD kalojnë në AAK.⁵ Pas kësaj, LDD në qendër ka kërcënuar me prishje të koalicionit, por praktikisht akoma koalicioni në nivel lokal mes këtyre dy subjekteve konsiderohet në fuqi. Pas

¹Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

²Ueb faqja zyrtare e Komunës së Pejës. Gjeografia dhe demografia e Komunës së Pejës. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/peje/City-guide/Geography.aspx>

³Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf

⁴Instituti për Studime të Avancuara GAP. Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë dhe ndikimi i tyre në Politikën Publike. Burimi: <http://institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>

⁵Gazeta 'Jeta në Kosovë'. LDD rishqyrton koalicionin me AAK. 26 janar, 2012. Burimi: <http://www.gazetajnk.com/?cid=1,1018,1216>

konstituimit të KK të Pejës, tre anëtar të Partisë Reformiste ORA i janë bashkangjitur LDK-së, e cila në zgjedhjet e drejtpërdrejta kishte fituar gjashtë ulëse.

Koalicioni qeverisës ka mbështetjen e 21 asambelistëve, 13 nga AAK, katër nga LDD dhe katër nga partitë minoritare të përfaqësuara në Kuvendin e Pejës.⁶

Pas aderimit në AAK të ish Kryetarit të Pejës nga radhët e LDK-së Ali Lajçi, nënkryetari Shefqet Ukaj pranon të dorëzojë postin e nënkryetarit dhe në vend të tij të emërohet nënkryetar Ali Lajçi. Ekzekutivi i Komunës së Pejës pranon dorëheqjen e Ukajt dhe si “shpërblim” vendos që djalin e tij Sokol Ukajn ta emërojë Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, duke shkarkuar nga kjo pozitë drejtoreshën e deriatëhershme Zana Radoniqi.⁷ Komuna e Pejës ka edhe dy nënkryetarë nga radhët e pakicave, Safet Zoraniç i cili përfaqëson subjektin politik të boshnjakëve VAKAT si dhe Drenko Todoroviq i cili vije nga subjekti politik “Alternativa Demokratike Serbe” (SDA).⁸

2. Problemet në Komunën e Pejës

Përveç problemeve të përgjithshme që ndërlidhen me ekonominë dhe papunësinë, banorët e Komunës së Pejës probleme për komunën e tyre i konsiderojnë edhe mos gëlqerosjen asnjëherë të objekteve të banimit kolektiv në qendër, mungesën e ashensorëve në këto objekte, mungesën e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit në disa zona të kësaj komune, mungesën e parkingjeve për vetura, derdhjen e kanalizimit në lumin e qytetit, mungesën e infrastrukturës adekuate në disa shkolla, mungesën e asfaltimit dhe rregullimit të rrugëve, prerja masive e pyjeve, nxjerrja e zhavorrit nga lumenjtë e komunës, vërshimet kohë pas kohe në disa zona të qytetit si dhe mbushja e deponisë aktuale për hedhjen e mbeturinave dhe pamundësia buxhetore e Komunës së Pejës për të hapur dhe menaxhuar një deponi të re.

Komuna ka investuar në rregullimin e sheshit, i cili ka nisur të dëmtohet në disa pjesë për shkak të materialit jo cilësor. Ndërtesat publike të cilat e përshkojnë hapësirën përreth sheshit nuk janë gëlqerosur asnjëherë. Në këto ndërtesa vërehet mungesa e dyerve të hyrjes, mungesa e dritareve nëpër shkallët e ndërtesës, shkallët nuk janë të pajisura me anësoret mbrojtëse, korridoret e brendshme të ndërtesave nuk kanë ndriqim gjatë natës, mungojnë ashensorët si dhe nuk janë hasur askund të vendosura aparatet për fikjen eventuale të zjarreve. Përveç kësaj, në disa ndërtesa publike hasen të

⁶ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet përfundimtare për Kuvendet komunale nga zgjedhjet lokale të vitit 2009. Fq 18. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKOZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/komune/ResultsByMunicipality.pdf>

⁷Gazeta ‘Kosova Sot’. AliLajçi emërohet nënkryetar i Pejës. 29 qershor, 2012. Burimi: <http://www.kosova-sot.info/politike/kosove/ali-lajci-emerohet-nenkryetar-i-pejes>

⁸Komuna e Pejës. Ueb faqja zyrtare. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/peje/Kryetari/Nenkryetart.aspx>

shpërfaqura kablo e instalimit të brendshëm elektrikë të cilat mund të paraqesin rrezik potencial për jetën e banorëve në ato ndërtesa, veçmas për fëmijët. Të tilla janë ndërtesat publike përgjatë rrugës “Mbretëresha Teutë”, përgjatë sheshit “Skënderbeu”, përgjatë sheshit “Dëshmorët”, prapa parkut “Ibrahim Rugova”, përgjatë rrugës “7 shtatori”, etj.

Në Pejë bije në sy prania e mbindërtimeve në shumicën e ndërtesave si dhe prania e dukshme e pompave të benzines në zonat urbane. Një e tillë është hapur para pak kohesh në zonën e quajtur “Karagaqi” afër pallatit të sportit.

Problem për Komunën e Pejës konsiderohet mungesa e objektit për shkollën e mesme të mjekësisë. Mbi një mijë nxënës të kësaj shkolle i zhvillojnë mësimin në objektin e shkollës filllore “Ramiz Sadiku”. Objekti për shkollën e mjekësisë është premtuar nga ana e autoriteteve të komunës që do të nis së ndërtuari para pesë viteve, por kjo nuk ka ndodhur. Biznesmeni nga Peja Ramiz Kelmendi ka nisur me fondet e tij të ndërtojë këtë shkollë, por me kusht që emri i babait të tij t’i vihet shkollës. Ky kusht është pranuar nga ana e përgjegjëseve të komunës, por jo edhe nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Kjo ka bërë që biznesmeni Kelmendi të heqë dorë nga ndërtimi i shkollës.

Një problem tjetër është zgjatja e reduktimeve të ujit të pijes, veçmas në vendbanimet urbane, ku më e prekur rezulton të jetë zona e Karagaqit. Reduktimet janë të theksuara në muajt e verës dhe ato gjatë një dite shkojnë deri në tetë orë. Komuna ka investuar në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në shumë zona. Investimet me të mëdha në këtë drejtim janë fokusuar në “Lugun e Beranit” nga vije edhe Kryetari i Komunës. Shuma e investuar vetëm në ujësjellës në fshatrat e “Lugut të Beranit” prekin shifrat e mbi 2 milionë eurove për tri vite.

Problem është edhe pamundësia e autoriteteve të kësaj ane për të zgjidhur problemin e derdhjes së kanalizimeve në lumin e qytetit Lumëbardhi. Me dhjetëra zona të qytetit dhe fshatrave përreth derdhjen e kanalizimeve e kanë të orientuar në rrjedhën e lumit duke shkaktuar kështu ndotje dhe herë pas here në disa pjesë edhe kundërmime erërash.

Komunat e Dukagjinit vlerësohen më të prekurat nga fenomeni i prerjes dhe dëmtimit të pyjeve. Në Pejë në tri vitet e fundit, ndonëse nuk kanë munguar përpjekjet për t’i parandaluar prerësit, gjendja akoma vlerësohet e keqe. Në disa raste janë prerë edhe pishat e mbjella dekada më herët. Ky fenomen në Komunën e Pejës është më i shfaqur në fshatrat e zonës së Rugovës. Kjo zonë është propozuar së fundi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të marrë epitetin e parkut nacional. Por, ky propozim nuk është përcjellë me hapa tjerë për konkretizimin e kësaj nisme e cila besohet që do të ndikonte në ashpërsimin e masave kundruall prerëseve ilegal të pyjeve. Krahas kësaj, lumenjtë e kësaj ane edhe me tutje vazhdojnë të degradohen nga nxjerrja e zhavorrit. Kjo është adresuar disa herë si problem, por asnjëherë nuk ka pasur rezultate konkrete në mënjanimin apo së paku në zvogëlimin e efekteve të dëmshme nga eksploatimi i zhavorrit.

Deponia e mbeturinave e cila gjendet në fshatin Cvërk, e hapur në vitin 2003 dhe e paraparë të shfrytëzohet deri në vitin 2009, ende vazhdon të shfrytëzohet si lokacion për hedhjen e mbeturinave. Edhe pse është kërkuar nga Komuna që të planifikojë hapjen e një deponie të re, autoritetet komunale këtë çështje e kanë parë si të vështirë ngase hapja dhe menaxhimi i një deponie të tillë kërkon investime deri në tre milion euro.

3. Performanca buxhetore e Komunës së Pejës

Komuna e Pejës hynë në mesin e tri komunave me të mëdha të vendit, pas Prishtinës dhe Prizrenit. Por për nga shkalla e të hyrave komunale, kjo komunë radhitet e pesta në vend. Peja ka më pak të hyra se Gjilani, Prizreni, Prishtina dhe Ferizaj.

Tabela nr.1: Shkalla e të hyrave komunale në Komunën e Pejës, Prizrenit, Gjilani dhe Ferizajt për vitin 2011

Komunat	Peja	Gjilani	Ferizaj	Prizreni
Shuma (euro)	2.604.370	3.525.274	3.415.117	4.999.570

Shkalla e të hyrave komunale në Pejë në tri vitet e fundit ka pasur një rrjedh përafërsisht të njëjtë. Shifra e borxheve që kanë qytetarët dhe bizneset kundruall komunës është tejet e lartë, veçmas në tatimin mbi pronën, borxh ky që sillet rreth 7 milionë euro. Pamundësia e mbledhjes së këtij borxhi nga ana e Komunës po e pamundëson rritjen e shkallës së përgjithshme të të hyrave në këtë komunë.

Tabela nr.2: Të hyrat komunale në Pejë gjatë katër viteve të fundit

Viti	2009	2010	2011	2012
Shuma (euro)	2.228.250	2.532.360	2.604.370	2.859.942

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) në raportin financiar 2011 për këtë komunë nxjerr vlerësime negative ndaj Komunës së Pejës duke u thirrur në atë se kjo komunë ka shpalosur pasqyra të pasakta të hyrash dhe kjo rrit pasaktësinë në shifra dhe krijon paqartësi për nivelin e të hyrave.⁹ Si përfundim ZAP nxjerr se Komuna e Pejës nuk ka kontroll të mirëfilltë ndaj të hyrave financiare dhe për rrjedhojë mund të vije deri të humbja dhe keqpërdorimi i parasë publike.

⁹Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit Financiar për Komunën e Pejës. 2011. Fq.13 & 17. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPE_2011_Shqip_280575.pdf

Sipas raporteve financiare të Ministrisë së Financave në dy vitet e fundit Komuna e Pejës ka pasur borxh të konsiderueshëm, përkatësisht fatura të papaguara ndaj operatorëve privat me të cilët ka kontraktuar punë publike. Kësisoj, viti 2011 ka nisur me gjithsej 577.130 euro fatura të papaguara, ndërsa vitit 2012 ka nisur me 558.710 euro fatura të papaguara. Lista e faturave të papaguara rezulton të jetë e gjatë dhe ato kryesisht kanë të bëjnë me mos pagimin e derivateve, botimeve, publikimeve, mirëmbajtjes së objekteve dhe automjeteve dhe kategorive tjera të linjës për mallra dhe shërbime.

Komuna e Pejës gjatë një viti ka në dispozicion mbi 19 milionë euro buxhet. Nga kjo shumë rreth 2.7 milionë euro janë të hyra vetanake, ndërsa pjesa tjetër e buxhetit përbehet nga granti i Qeverisë së Kosovës për komuna.

Tabela nr.3: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Pejës për tri vitet

Kategoria	Plani 2013	2012	2011
Investime Kapitale	5.853.728	5.357.554	6.129.686
Mallra dhe shërbime	2.343.763	2.373.793	2.083.117
Subvencion dhe transfere	350.000	374.000	348.749
Shpenzime komunale	591.914	557.800	511.208
Paga	10.512.912	10.291.389	10.015.112
Totali	19.652.317	18.954.536	19.087.873

Nga të dhënat e mësipërme haset se Komuna e Pejës për një vit për linjën mallra dhe shërbime ka në dispozicion mbi 2.3 milionë euro. Krahasimi mes viteve nga tabela e mësipërme nxjerr në pah se buxheti i Komunës së Pejës për investime kapitale gjatë vitit 2011 ka qenë më i madh krahasuar me vitin 2012 dhe planifikimet për vitin 2013. Përderisa ka rënie në investime kapitale, vërehet rritje e buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Kësisoj, në këtë kategori gjatë vitit 2011 kanë qenë në dispozicion më pak se 2.1 milionë euro, përderisa një vit me vonë (2012) në këtë kategori janë alokuar afro 2.4 milionë euro.

Tabela nr.4: Krahasimi i shpenzimeve në linjën për mallra dhe shërbime të vitit 2011 me vitin 2010

Kategoria	2010	2011
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	14.004	14.131
Mëditje për udhëtime jashtë vendit	9.980	8.676
Akomodim për udhëtime jashtë vendit	1.290	9.003
Shpenzime tjera për udhëtime jashtë vendit	1.613	1.288
Shpenzime në telefonin mobile	13.057	27.432
Shpenzime në telefonin fikse	36.637	39.444
Shpenzime postare	977	7.132
Shpenzime për këshillime intelektuale	00	40.659

Shërbime tjera kontraktuese	192.884	600.954
Shpenzime -naftë për ngrohje	78.057	125.451
Blerja e druve	97.370	186.423
Derivate për gjenerator	26.179	87.668
Karburant për vartura	100.503	120.107
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	60.628	61.771
Mirëmbajtja e ndërtesave	27.153	13.162
Mirëmbajtja e rrugëve	6.604	51.612
Dreka dhe darka zyrtare	59.852	77.332

Nga të dhënat zyrtare rezulton se krahasimi i shpenzimeve mes vitit 2011 dhe 2010 ka rritje të theksuar shpenzimesh në shumë kategori. Kësisoj për telefona mobil gjatë vitit 2011 janë shpenzuar mbi 14.000 euro më shumë se një vit më herët, ndërsa tek kategoria dreka dhe darka zyrtare gjatë vitit 2011 janë shpenzuar mbi 17.000 euro më shumë. Rritje të theksuar shpenzimesh hasen edhe në kategorinë e blerjes së naftës për ngrohje, derivate për vetura si dhe naftë për gjenerator.

Përderisa në linjën e buxhetit për mallra dhe shërbimeve janë evidentuar rritje të shpenzimeve, në linjën për shpenzimet komunale ka pasur rënie të lehtë shpenzimesh gjatë vitit 2011.

Tabela nr.5: Prezantimi i shpenzimeve në linjën e shpenzimeve komunale për vitin 2010 dhe krahasimi me vitin 2011 dhe 2012

Kategoria	2010	2011	2012
Pagesat për energji elektrike	347.023	344.413	389.025
Pagesat për ujë	70.595	83.439	89.452
Pagesat për mbeturina	51.496	33.051	39.733

Tabela nr.6: Shpenzimet në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime në Komunën e Pejës për vitin 2012

Kategoria	2012
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	12.648
Mëditje për udhëtime jashtë vendit	11.492
Akomodim për udhëtime jashtë vendit	4.694
Shpenzime në telefonin mobile	40.282
Shpenzime në telefonin fikse	38.872
Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	83.100
Botime dhe Publike	10.356
Reklama dhe Konkurse	2.778
Shpenzime -naftë për ngrohje	224.059
Blerja e druve	136.700

Derivate për gjenerator	99.005
Karburant për vartura	241.729
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	97.714
Mirëmbajtja e ndërtesave	22.541
Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore	150
Mirëmbajtja e shkollave	75.636
Furnizim për zyre	122.248
Dreka dhe darka zyrtare	76.820
Shpenzimet për informime publik	12.005

Tabela nr.7: Vlerësimi i totalit të shpenzimeve (në euro) gjatë vitit 2010 dhe 2011 si dhe krahasimi me vitin 2012 në disa kategori nga Komuna e Pejës

Kategoria	2010	2011	2012	Totali
Dreka Zyrtare	59.852	77.332	76.820	214.004
Telefoni mobile	13.057	27.432	40.282	80.771
Telefoni fikse	36.637	39.444	38.872	114.953
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	14.004	14.131	12.648	40.783
Mëditje për udhëtime jashtë vendit	9.980	8.676	11.492	30.148
Akomodim për udhëtimet jashtë vendit	1.290	9.003	4.694	14.987
Shpenzime - naftë për ngrohje	78.057	125.451	224.059	427.567
Blerja e druve	97.370	186.423	136.700	420.493
Shpenzime në derivate për gjenerator	26.179	87.668	99.005	212.852
Shpenzime për karburant për vetura	100.503	120.107	241.729	462.339
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	60.628	61.771	97.714	220.113

Komuna e Pejës për tri vite ka shpenzuar afro 86.000 euro për mëditje, udhëtime dhe akomodim jashtë vendit. Në telefon mobil dhe fiks për të njëjtën periudhë (2010-2012) nga Komuna e Pejës janë shpenzuar afro 196.000 euro. Ndërkaq, nëse i llogarisim shpenzimet për naftë, pa përfshirë naftën për ngrohje, ku hyjnë shpenzimet për gjenerator dhe naftë për vetura, Komuna e Pejës për tri vite ka shpenzuar mbi 675.000 euro. Për derivate për gjenerator gjatë periudhës 2010-2012 janë shpenzuar afro 213.000 euro. Shifër e lartë haset të shpenzohet nga Komuna e Pejës edhe në kategorinë e mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve ku mbi 220.000 euro janë shpenzuar për tri vite nga Peja për në këtë drejtim.

Për vitin 2013 nga gjithsej 19.652.317 euro sa ka buxhet Komuna e Pejës, 2.343.763 euro janë te parapara për linjën mallra dhe shërbime, apo rreth 12% e buxhetit total.

4. Investimet kapitale

Investimet kapitale në Komunën e Pejës gjatë tri viteve të kaluara kanë pasur një shtrirje relativisht të gjerë dhe ato janë fokusuar kryesisht në rregullimin e rrugëve, përfshirë rehabilitimin, asfaltimin dhe pjesërisht ndriçimin e tyre, si dhe investime në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit. Investimet më të mëdha gjatë tri viteve në Komunën e Pejës kanë qenë rregullimi i sheshit kryesor të qytetit se bashku me parkun, instalimi i rrjetit të ujësjellësit në zonën e fshatrave të quajtura “Lugu i Beranit”, ndërtimi i objektit të ri të administratës komunale si dhe rregullimi i objektit të sportit “Karagaqi”. Shuma e përgjithshme e mjeteve që ka në dispozicion Komuna e Pejës gjatë një viti për investime kapitale sillet rreth 5.8 milionë euro.

Tabela nr. 8: Pasqyrimi i investimeve të mëdha të Komunës së Pejës në linjën e investimeve kapitale gjatë vitit 2010, 2011 dhe 2012


Projektet kryesore të realizuara gjatë 2012	Shuma (euro)
Asfaltimi i rrugës për në fshatin Zllapek	98.114
Ndërtimi i kanalit të ujësjellësit në fshatin Loxhë	152.000
Ndërtimi i kanalizimit fekal, Vitomiricë - Qyshk	185.105
Asfaltimi i rrugës “Rrustem Bruqi”	31.832
Asfaltimi i rrugës kryesore në fshatin Qollapek	36.765
Ndërtimi i kanalit të ujësjellësit për fshatin Qyshk	13.913
Asfaltimi i rrugës F.Xh.Bajder - Dardani	66.962
Rregullimi i rrugës Bajram Kelmendi - Qendra	16.980
Rr. me kubëza betoni i Rr.Nuredin Ceku - S.Kulla	18.893
Asfaltimi i rrugëve: Sali Jaha-	49.600
Ujësjetësipërfshatrat e Lugut të Baranit	470.000
Asfaltimi i rrugës në fshatin Shtypeq i madhë	96.550.
Asfaltimi i rrugës në fshatin Pavlan	74.010
Asfaltimi i rrugëve Pal Engjëlli -Sahat Kulla	21.112
Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011	Shuma (euro)
Rregullimi i trotuareve në rrugën "Beteja e Koshares" dhe "Bekim Berisha"	42.787
Asfaltimi i rrugës në fshatin Ruhot	98.496
Asfaltimi i rrugës në fshatin Drelaj	132.000
Asfaltimi i rrugës në fshatin Rashiq faza II-të	70.662
Asfaltimi i rrugës në fshatin Kotradiq	55.969
Rregullimi i një pjese të lumit Lumbardhë	299.800
Rregullimi i kanalit të ujësjellësit për fshatin Raushiq	35.185
Ndërtimi i objektit për menaxhimin e emergjencave	161.075
Ndërtimi i shtatë zyrave të vendit	81.521
Ndërtimi i kanalit të ujësjellësit në fshatin Llozhan	25.200
Ndërtimi i aneksit të administratës komunale	329.958
Rregullimi i rrugës “Kasum Shala”	17.810

Instalimi i ujësjellësit ne fshatin Stankaj	55.377
Rregullimi i kanalit te ujitjes ne fshatin Nabergjan	62.100
Rregullimi dhe asfaltimi i disa rrugëve në Loxhë	59.944
Ndërtimi i ujësjellësit ne fshatin Stankaj	55.377
Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010	Shuma (euro)
Hapja e rrugës së re në fshatin Dugaivë	11.800
Rregullimi i rrugës “Qajupi”	21.928
Rregullimi i rrugës Drelaj – Koshutan	132.000
Rregullimi i rrugës “Kristal”	22.367
Rregullimi i rrugës “Rexhep Sokoli”	24.9
Ndërtimi i urës ne fshatin Nepole	14.993
Rregullimi i rrugës “Kalaja”	17.337
Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës “Bujar Berisha”	37.334

Në disa raste në Komunën e Pejës është evidentuar cilësi tejet e dobët e punimeve gjatë investimeve kapitale të cilat më pastaj kanë detyruar autoritetet e komunës të investojnë apo planifikojnë rishtas fonde. Shembull konkret për këtë shërben rruga me gjatësi 2.5 kilometra e quajtur si rruga e “Vitomiricës”. Kjo rrugë është inauguruar me 28 nëntor të vitit 2012 në shenjim të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Dy muaj pas kësaj komuna është detyruar të heq shtresën e epërme të asfaltit për shkak të dëmtimeve të pësuarra dhe në pranverën e vitit 2013 pritet të ri-shtrohet me asfalt serish ajo rrugë.

Nw vitin 2013 Komuna e Pejës ka nw dispozicion afro 5.9 milion euro pwr investime kapitale. Sipas planifikimeve buxhetore pwr 2013, investimet kapitale do tw shfrytwzohen pw shtrim rrugwsh (16.9% e buxhetit pwr investime kapitale), arsim (6%), kulturw, rimi dhe sport (4.8%), etj.

Grafikoni nr.1: Investimet kapitale 2013 – Komuna e Pejës¹⁰



5. Aktivitetet e Prokurimit Publik

Komuna e Pejës fushën e prokurimit publik e ka të rregulluar në nivel të zyrës e cila sipas organogramit funksionin brenda Drejtorisë së Administratës. Kjo zyre ka gjithsejtë pesë persona të punësuar, ku njëri nga ta mban pozitën e Shefit të Zyrës së Prokurimit. Për tri vite (2010-2012) Komuna e Pejës ka lidhur 667 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, me një vlerë të kontratave mbi 13 milionë euro.

Tabela nr.9: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Pejës 2010 -2012

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (euro)
2010	252	4.665.383,75
2011	269	4.810.275,55
2012	146	3.952.114,02
Totali	667	13.427.773,32

Për vitin 2012 të dhënat përfshijnë vetëm njoftimet e KRPP-së

¹⁰ Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?peje/2013#/~peje/shpenzimet-kapitale>

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) në raportin për Komunën e Pejës (2011) ka vërejtur se mungon fletë dërgesa dhe raporti i pranimit të mallit për një pagesë në vlerë prej 2.910 euro dhe 14.730 euro të bëra për furnizim me dru për ngrohje. Sipas ZAP-it, rastet e përshkruara me lartë tregojnë për mangësi të kontrollit të aktiviteteve. Mungesa e rregullave të brendshme dhe politikave si dhe gabimet në udhëheqjen e procedurave kanë shkaktuar dështime edhe në procedurat e kontrollit. Pagesat e bëra pa raporte të organit mbikëqyrës, rrisin rrezikun që pagesat të bëhen edhe për punët që nuk janë kryer fare.¹¹

Rastet e shkeljeve të rregullave të prokurimit publik nga ana e autoriteteve të Komunës së Pejës janë konstatuar disa herë radhazi edhe nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Në një rast që ka të bëjë me blerjen e një automjeti të zjarrfikësve, pas marrjes së një ankese OSHP ka urdhëruar Komunën e Pejës që të anulojë tenderin me arsyetimin e shpërfilljes së rregullave të prokurimit.¹² Vendime të njëjta me këtë gjatë tri viteve të fundit OSHP ndaj Komunës së Pejës ka nxjerrë edhe në nëntë raste të tjera.

6. Administrata e Komunës së Pejës

Komuna e Pejës ka gjithsej 352 persona të punësuar në administratën komunale, duke përfshirë zjarrfikësit, të punësuarit në Qendrën për Punë Sociale dhe në institucionet kulturore. Ndërsa së bashku me sektorin e arsimit, ku përfshihen të punësuarit në çerdhen e qytetit, në shkollat fillore dhe ato të mesme si dhe në sektorin e shëndetësisë, numri i të punësuarve në institucionet publike komunale është 2.193 persona.

Tabela nr.10: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Pejës dhe vështrimi gjinor

Sektorët	Numri i të punësuarve	M	F
Zyra e Kryetarit	8	6	2
Drejtoria e Administratës	57	44	13
Drejtoria e Inspektionit	25	23	2
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	33	23	10
Drejtoria për Shërbime publike	12	8	4
Drejtoria për Mbrojtje dhe shpëtim	5	5	0
Zyra për Komunitete	8	5	3
Drejtoria për Bujqësi	24	23	1
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	7	5	2

¹¹Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit Financiar për Komunën e Pejës. 2011. Fq-19. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPE_2011_Shqip_280575.pdf

¹²Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura. Datë 13.10.2012. nr. 193/12. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2012/Blerja%20e%20nje%20automjeti%20per%20shuarjen%20e%20zjarrit.pdf>

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster	18	12	6
Drejtoria e Urbanizimit	13	5	8
Drejtoria e Shëndetësisë	22	10	12
Drejtoria e Arsimit	14	8	6
Drejtoria për Kulturë dhe institucionet varesë të saj	50	32	18
Njësia e Zjarrfikëseve	39	39	0
Drejtoria për integritet evropiane	1	1	0
Drejtoria për Çështje pronësore Juridike	4	4	0
Zyra për marrëdhënie me publikun	2	2	0
Zyra e Prokurimit Publik	5	3	2
Zyra administrative e Kuvendit	2	2	0
Zyra e Auditimit të brendshëm	3	3	0
Gjithsej	352	263	89

Komuna e Pejës rezulton më së keqi në krahasim me komunat e mëdha të vendit për sa i përket përfaqësimit të femrës në pozitat e punës. Ndonëse dy drejtori të kësaj komune udhëhiqen nga femrat (Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria e Kulturës) numri i përgjithshëm i femrave të punësuar në dikasteret e komunës del të jetë tejet i vogël. Kësisoj nga 352 të punësuar si shërbyes civil, vetëm 89 prej të janë femra. Në këtë mënyrë, Komuna e Pejës është lar përmbushjes së kriterit prej 40% të të punësuarave femra, ashtu siç kërkohet me Ligjin për barazi Gjinore. Numri i femrave të punësuar është i vogël edhe në sistemin arsimor dhe atë shëndetësor të kësaj komune.

Komuna e Pejës del e para në vend për numrin e Drejtorive Komunale. Peja ka Drejtori edhe me shume se Prishtina. Të dhënat e mëposhtme tregojnë me mënyrë grafike numrin e drejtorive sipas komunave të vendit.

7. Arsimi në Komunën e Pejës

Komuna e Pejës konsiderohet e përafërt me Komunën e Prishtinës për nga numri i shkollave fillore. Në këtë qytet funksionon vetëm një çerdhe për fëmijë, por që kapaciteti i saj është i barabartë me një shkollë fillore. Komuna e Pejës ka 28 shkolla fillore, dhe bashkë me paralelet e ndara numri i objekteve shkollore arrin në 47. Ndërsa numri i shkollave të mesme është shtatë. Në Pejë ekzistojnë pothuajse të gjitha profilet e shkollimit të mesëm, gjimnaz matematikor, gjimnaz natyrorë, shkolla teknike profesionale, shkolla e ekonomisë, profili i muzikës, filologjisë si dhe drejtimi i mjekësisë.

Tabela: nr.11: Numri i fëmijëve dhe i personelit në çerdhen e Pejës dhe vështrimi gjinor

Numri i fëmijëve	F	M	Numri i edukatoreve	F	M	Personeli ndihmës	F	M
406	220	186	45	45	0	17	14	3

Tabela nr.12: Numri i mësimdhënëseve dhe stafit përcjellës në 47 shkollat fillore dhe shtatë shkolla të mesme të Pejës:

Gjinia	Shkolla fillore		Shkolla të mesme	
	Mësimdhënës	Stafi ndihmës	Mësimdhënës	Stafi ndihmës
Femra	540	24	162	6
Meshkuj	339	87	240	31
Gjithsejtë	879	111	402	37

Tabela nr.13: Numri total i mësimdhënëseve, nxënëseve dhe stafit ndihmës në 47 shkolla fillore dhe shtatë shkolla të mesme në Komunën e Pejës

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	1.281	702	579
Nxënës	21.640	10.082	11.558
Stafi ndihmës	148	30	118

Tabela nr.14: Numri total i të punësuarve në sektorët që mbulojnë nga Komuna e Pejës

Sektorët	Numri
Komuna e Gjakovës	352
Arsimi fillor dhe i mesëm	1.429
Çerdhet	62
Shëndetësia	350
Totali	2.193

Investimet në infrastrukturën e shkollave të Pejës kryesisht janë fokusuar në riparimin e kulmeve, riparimin dhe transformimin e sistemit të ngrohjes, renovime të brendshme të shkollave, ndërrimin e dyerve dhe dritareve dhe gëlqerosje të objekteve. Ndërtim të shkollave të reja nuk ka pasur. Gjatë periudhës 2010-2012 nuk është hasur ndonjë investim i madh në Komunën e Pejës nga ana e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Tabela nr.15: Disa nga investimet ne shkollat e Pejës gjatë periudhës 2010 -2012

Investimet	Shuma
Vazhdimi i punimit të aneksit në shkollën fillore “Dëshmoret e Kombit”	18.865
Riparimi i parketit në shkollën fillore “Asdreni”	12.950
Ndërtimi i objektit për lënien e druve për ngrohje ne shkollën e Zahaqit “Haxhi Zeka”	2.500
Ndërtimi i kulmit nëshkollën“Halit Kasapolli”	10.000
Ndërtimi i aneksit dhe fasadimi i shkollës “Zenel Hajdini”	116.942
Riparimi i kulmit dhe gëlqerosja e shkollës “Lidhja e Prizrenit”	33.513
Rregullimi i kulmit në shkollën “Naum Veqilhargji”	27.791
Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore në fshatin Beran	47.302
Riparimi i shkollës “Skënderbeu” në Treboviq	22.804
Transformimi i ngrohjes qendrore në shkollën e mesme “Bedri Pejani”	11.000

8. Transparenca në Komunën e Pejës

Komuna e Pejës gjatë tri viteve të fundit (2010-2012) ka përmirësuar dukshëm nivelin e transparencës komunale. Ueb faqja zyrtare e Komunës posedon materiale dhe informata të shumëllojshme për shumicën e sferave që mbulon Komuna dhe po ashtu janë të publikuara edhe raportet financiare të këtij institucioni, si në lëmin e të hyrave ashtu edhe atë të shpenzimeve të parëse publike. E kënaqshme ka qenë edhe përgjigja e Komunës në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumentet publike.

Po ashtu vlerësohet e kënaqshme edhe sasia e informatave që korrespondent e medieve të shkuara marrin nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun. Pasqyrime të detajuara për zhvillimet në Komunë të Pejës bëjnë mediat lokale, si RTV “Dukagjini” dhe televizioni “Syri Vision”. Këto media mbulojnë gjerësisht zhvillimet e përditshme në Komunën e Pejës si dhe pasqyrojnë kohë pas kohe problematikat e ndryshme në këtë komunë.

Tabela: nr.16: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Pejë

<http://kk.rks-gov.net/peje/>

Dokumenti	2010				2011				2012			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	I V
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x	√
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	x	x	x	x	√	√	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	√	x	x	√	√	x	√	√
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	√	x	x	x	√	√	x	x	√
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	x	x	x	√	x	x	x	√	√	x	√	√
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	√	√	x	√	√
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	x	√	x	√	√	x	√	x	√	x	√	√
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	x	x	x	√	x	x	x	√	√	x	x	√
Drejtoria për Shërbime Publike	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	√	x
Planifikim dhe Urbanizëm	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x	√
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	x	x	x	x	√	√	x	x	√
Drejtoria e Bujqësisë	x	x	x	x	x	x	x	√	√	√	x	√
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	x	x	x	√	x	x	x	√	√	x	x	√
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	√	√
Zyra e Prokurimit	√				√				√			
Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm	x				x				x			
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	√				√				√			
Rregulloret Komunale	√				√				√			
Vendimet e Kuvendit Komunal	√				√				√			
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	√											
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	X	x	x	x	x	x	
Planet dhe Strategjitë e Komunës	√											

X = mungon raporti.

√ = raporti është i publikuar në ueb-faqe.

9. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009 kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z.Ali Berisha, para elektoratit të tij ka shpalosur premtime në sfera të ndryshme. Pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në fund të vitit 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës, të cilit iu përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizimin e tyre.

Tabela e mëposhtme vlerëson progresin e arritur në realizimin e premtimeve të dhëna në vitin 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 18 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas tri viteve të qeverisjes në Komunën e Pejës, 7 premtime janë përbushur, 7 tjera nuk janë përbushur, ndërsa në 4 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen akoma premtime të përbushura.

Premtimet e 2009	Realizimi 2010-2012
Ndërtimi i ujësjellësit dhe rregullimi i rrugës në zonën e quajtur Kelmendi	Rruga kryesore është rregulluar dhe asfaltuar. Ujësjellësi është instaluar, përkatësisht gypi kryesor është dërguar deri në zonën e quajtur Kelmendi, por akoma nuk është bërë shpërndarja e tij nëpër lagjet e banuara. Ky premtim vlerësohet i përbushur.
Për fshatrat Arbanë, Ruhot dhe Radavc asfaltimi i rrugëve, instalimi i ujësjellësit si dhe ndërtimi i një shkolle të re	Shkolla në këto fshatra është ndërtuar nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht me ndërhyrjen e zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Kosovës, Hajredin Kuqi, i cili vije nga këto zona. Rrugët pjesërisht janë asfaltuar, ndërsa mungon akoma rrjeti i ujësjellësit. Ky premtim vlerësohet pjesërisht i përbushur.
Për fshatrat e “Lugut të Beranit” instalimi i rrjetit të ujësjellësit, asfaltimi i rrugëve dhe ofrimi i ndihmës në sferën e bujqësisë	Ky premtim mund të vlerësohet i përbushur, ngase investimet në rrjetin e ujësjellësit në këtë zonë vetëm në dy vitet e fundit tejkalojnë shumën e 2 milionë eurove. Rrugët kryesore janë asfaltuar, ndërsa ndihma në bujqësi ka qenë më e madhe krahasuar më periudhën e para zgjedhjeve lokale.

Rregullimi dhe mirëmbajtja e të gjitha rrugëve në rajonin e Rugovës	Premtim i pa përmbushur. Pjesa më e madhe e rrugëve janë të paasfaltuara në rajonin e Rugovës. Mos rregullimi i rrugëve ka për pasojë edhe pamundësinë e mirëmbajtjes së tyre.
Zhvillimi i bujqësisë dhe turizmit.	Zhvillimi i bujqësisë në rajonin e Pejës në tri vitet e fundit ka shënuar progres. Investimet komunale kanë qenë të kënaqshme në rregullimin e kanaleve të ujitjes. Për turizëm ka pasur disa investime të vogla, por pjesa më e madhe e investimeve në këtë lami kanë qenë të sektorit privat. Ky premtim mund të vlerësohet pjesërisht i përmbushur.
Për fshatin Raushiq asfaltimi i rrugëve dhe instalimi i rrjetit të ujësjellësit	Premtim i përmbushur. Të dy këto projekte janë realizuar për këtë fshat.
Angazhimi për një administratë më efikase	Premtim i përmbushur. Komuna e Pejës ka ndërtuar një qendër të administratës në qendër të qytetit dhe ka lehtësuar dhe përshpejtuar procedurat për marrjen e shërbimeve të ndryshme nga gjendja civile.
Rregullimi i rrugës në relacionin e fshatrave Malaj – Pepaj	Premtim i pa përmbushur. Kjo rrugë akoma vazhdon të mbetet e pa rregulluar.
Shtrimi dhe rregullimi i gjitha rrugëve dhe ujësjellës për të gjitha shtëpitë e Pejës	Premtim i pa përmbushur. Shumë rrugë nuk janë asfaltuar dhe shumë zona nuk janë nën sistemin e ujësjellësit.
Rregullimi i kanalizimeve për të gjitha zonat e Pejës.	Premtim i pa përmbushur. Me së paku investime në këto tri vite në Pejë ka pasur për kanalizim.
Krijimi i kushteve të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarive banesore në Pejë	Nuk është vërejtur ndonjë investim i posaçëm i cili do të mund të konsiderohet si faktor që ka ndihmuar bizneset në regjionin e Pejës.
Investime kapitale në Komunën e Pejës nga buxheti komunal dhe nga investitorët e huaj në vlerë deri në 30 milionë euro	Premtim pjesërisht i përmbushur. Vlera e investimeve kapitale në Pejë në tri vitet e fundit nuk kalojnë shifrën e 15 milionë eurove. Nuk ka pasur ndonjë investim të madh nga ana e donatorëve ndërkombëtar në këtë komunë.
Punësimi i 3.500 qytetarëve përmes projekteve komunale dhe atyre të donatorëve	Premtim i pa përmbushur. Nuk ka pasur ndonjë projekt komunal i cili në mënyrë të dukshme do të ndikonte në zbutjen e papunësisë në këtë rajon.

Hartimi i projekteve rregulluese për zonat urbane të qytetit	Premtim i përmbushur. Pjesa dërrmuese e planeve rregulluese janë hartuar dhe miratuar. Mbetet problematik shkalla e ulet e përfilljes së këtyre planeve edhe nga vetë autoritetet.
Zgjidhja e problemeve nga ujerat e zeza dhe mbeturinave	Premtim i pa përmbushur. Ujerat e zeza vazhdojnë të hedhen në shtratin e Lumëbardhit dhe investimet në këtë drejtim kanë munguar.
Ndërtimi i një impianti për ujerat e zeza në bashkëpunim me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë	Premtim i pa përmbushur. Nuk ka pasur as nisma të kësaj natyre.
Reduktimi i prerjeve ilegale të pyjeve dhe nxjerrjes së zhavorrit nga lumenjtë	Premtim pjesërisht i përmbushur. Dukuria e prerjes ilegale të pyjeve është zvogëluar, por jo edhe pamundësuar. Ngjashëm qëndron gjendja edhe për sa i takon nxjerrjes së zhavorrit nga lumenjtë e kësaj ane.
Rregullimi i stadiumit të qytetit në partneritet publiko – privat	Premtim i përmbushur. Ka pasur investime të vazhdueshme në stadiumin e qytetit në tri vitet e fundit.

10. Burimet

1. Komuna e Pejës. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Raporti Financiar, janar dhjetor -2010. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/peje/Departments/Finance,-Economy-and-Development.aspx>
2. Komuna e Pejës. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Raporti Financiar janar - dhjetor 2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/peje/Departments/Finance,-Economy-and-Development.aspx>
3. Komuna e Pejës. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Raporti financiar janar - qershor 2012. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/peje/Departments/Finance,-Economy-and-Development.aspx>
4. Komuna e Pejes. Drejtoria e Administrates se Pergjithshme. Lista e të punësuarëve në administratën dhe organet komunale.
5. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
6. Raportet vjetore 2011 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu_OpenNode=90
7. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Pejës. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=67734>
8. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për vitin 2011 për Komunën e Pejës. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPE_2011_Shqip_280575.pdf
9. Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura për Komunën e Pejës. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>
10. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf
11. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf
12. Instituti për Studime të Avancuara GAP. Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë dhe ndikimi i tyre në Politikën Publike. Burimi: <http://institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>
13. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e raundit të dytë të rezultateve për zgjedhjet lokale të vitit 2009. Fq 10. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ->

- WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/rezultatetkk_r
aundi%202.pdf
14. Komuna e Pejes. Zyra e Kryetarit. Raporti i Punës së Komunës së Pejës 2011.
Burimi: <http://kk.rks-gov.net/peje/getattachment/Temat/Raportet/raporti-2011.pdf.aspx>
 15. Ueb faqja zyrtare e Komunës se Pejës. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/peje/>
 16. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011. <http://mf.rks-gov.net/sql/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiqendrore.aspx>